



## *fq. 2* Zhvillohet Konferenca e 40-të Vjetore e IOSCO-s

### VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2015 fq. 4

### ZHVILLIME TË TJERA

- » AMF zhvillon trajnime për vlerësues dëmsh në sigurime fq. 6
- » Simpoziumi i XIII ndërkombëtar i sigurimeve “Menaxhimi i rrezikut të katastrofave dhe zhvillimi i qëndrueshëm” fq. 7
- » Takimi i grupit të punës mbi pensionet private dhe i përfaqësuesve të vendeve anëtare të IOPS-it fq. 8

### LAJMET NGA RAJONI

- » Bosnje-Hercegovina fq. 9
- » Bullgari fq. 9
- » Çeki fq. 10
- » Lituani fq. 10
- » Maqedoni fq. 11
- » Serbi fq. 11
- » Slloveni fq. 12
- » Turqi fq. 12

## Zhvillohet Konferenca e 40-të Vjetore e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) zhvilloi në 14-18 qershor 2015 në Londër, Konferencën e 40-të Vjetore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, është anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë.

Tema e Konferencës Vjetore ishte “Ndërtimi i një botë të re financiare”. Ajo u fokusua në standardet e sjelljes, në risitë financiare dhe sfidat me të cilat përballen sot rregullatorët financiarë dhe industria.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Greg Medcraft theksoi ndër të tjera se “Afhenda e punës sonë vazhdon, për të nxjerrë më në pah dhe për të përforcuar rolin tonë si pikë kyçe referimi globale për rregullimin e letrave me vlerë gjatë kësaj periudhe ndryshimi të shpejtë. Ne vazhdojmë të jemi proaktivë dhe të shohim përpara duke kërkuar ndërtimin e besimit në tregje, të cilat janë duke ndeshur mundësi dhe rreziqe të reja, duke përfshirë edhe ato që vijnë nga teknologjia dixhitale”.

Bordi diskutoi drejtimin strategjik për IOSCO-n deri në vitin 2020, burimet dhe mjetet e Planit të Veprimit. Drejtimi strategjik parashikon që në vazhdimësi, gjatë kësaj dekade, IOSCO të përforcojë pozitën e saj si pikë kyçe referimi mbarë botërore në rregullimin e letrave me vlerë. Drejtimi strategjik dhe objektivat do të realizohen përmes 43 nismave të Planit të Veprimit që mbulojnë gjashtë fusha prioritare.

- » Kërkimi dhe identifikimi i rrezikut;
- » Vendosja e standardeve dhe hartimi i udhëzuesve;
- » Monitorimi i zbatimit të standardeve të vendosura nga IOSCO;
- » Ndërtimi i kapaciteteve të vendeve anëtare, veçanërisht në rritjen e tregjeve të reja;
- » Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi;
- » Angazhimi dhe bashkëpunimi me organizata të tjera ndërkombëtare.

Komiteti i Tregjeve në Rritje dhe Zhvillim (*Growth and Emerging Market, GEM*) më i madhi ndër komitetet e IOSCO-s, me 90 anëtarë, në takimet e tij përforcoi rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të përbashkëta rregullatore, duke përfshirë edhe identifikimin dhe administrimin e rrezikut sistemik. Anëtarët ranë dakord për të drejtuar politikat në fushat e mëposhtme prioritare:

- » Ndikimi i dixhitalizimit dhe risitë në tregjet e kapitalit;
- » Forcimi i qeverisjes së korporatave;
- » Zhvillimi i mjeteve dhe udhëzimeve për administrimin e krizave dhe ngjarjeve të paparashikuara për tregjet në zhvillim.

Gjatë konferencës u zhvilluan edhe mbledhjet e katër komiteteve rajonale të IOSCO-s, si edhe mbledhja e Komitetit Këshillues të saj.

Në fushën e politikave, Bordi i IOSCO-s diskutoi përparimin në një numër fushash, duke përfshirë:

- » Adresimin e sfidave të rregullimit ndërkufitar;
- » Përmirësimin e qeverisjes së organizmave audituese ndërkombëtare që vendosin standardet;
- » Rritjen e qëndrueshmërisë së tregjeve të letrave me vlerë dhe pjesëmarrësve të tregut ndaj sulmeve kibernetike;
- » Rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit nëpërmjet Memorandumit Multilateral të Mirëkuptimit duke marrë parasysh zhvillimet e fundit të tregjeve, teknologjitë dhe praktikatat e zbatimit;
- » Sigurimin e përfshirjes së investitorëve në zhvillimin e politikave;
- » Lehtësimin e rritjes së kapitalit të SME-ve, duke përfshirë financimin e gjerë nga investitorë të vegjël (*crowd-funding*) dhe duke i mbrojtur ata.

Bordi diskutoi edhe për drejtimit në lidhje me administrimin e asetëve, sjelljen në treg, punën për rritjet e kapaciteteve, etj.

Në konferencën vjetore ishin të pranishëm me diskutimet e tyre personalitete të ndryshme të fushës së ekonomisë dhe financës si Harriett Baldwin, Ministre e Ekonomisë në Mbretërinë e Bashkuar (*Economic Secretary to HM Treasury*), Marc Carney, Guvernator i Bankës së Anglisë dhe Kryetar i Bordit të Qëndrueshmërisë Financiare, John Griffith Jones, Kryetar dhe Martin Wheatley, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Rregullator Financiar në Mbretërinë e Bashkuar (FCA), si dhe një sërë drejtuesish të autoriteteve rregullatore apo institucioneve financiare.

Në diskutimet e mbajtura si dhe në dy workshop-e të organizuara përkatësisht me temat: "Qëndrimi i fortë dhe i besueshëm në zbatueshmërinë e kuadrit rregullator të tregjeve të letrave me vlerë" dhe "Konsumatorët e cenueshëm", thelbi qëndronte pa dallim në nevojën për të mbrojtur konsumatorët.

Mbrojtja e konsumatorëve kërkon forcim të qëndrimit të autoriteteve rregullatore në drejtim të zbatueshmërisë së kuadrit rregullator; ndëshkim të sjelljes së gabuar në treg nga ana e operatorëve; forcim të sistemit të ndëshkimit të sjelljes së gabuar në treg duke përdorur sistemin e ndëshkimeve administrative dhe penale; rritje të bashkëveprimit të autoriteteve rregullatore me pushtetin gjyqësor për të siguruar ndëshkimin penal të keqbërësve; mbajtjen përgjegjës për veprimin e operatorëve të bordeve të tyre jo vetëm kolektivisht, por edhe individualisht të anëtarëve të bordit; si dhe forcim të qeverisjes së vetë autoriteteve rregullatore dhe bashkërendimit ndërmjet tyre në nivel botëror.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 17.44% gjatë periudhës janar-maj 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 5.2 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 8.46% duke arritur në 395,185 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 19.12% në krahasim me periudhën janar-maj 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.89 miliardë lekë, apo 71.49% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 21.73% gjatë periudhës janar-maj 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-maj 2014.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 2.98 miliardë lekë gjatë periudhës janar-maj 2015, duke shënuar një rritje prej 27.90% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 57.91% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 15.42% të tregut të Jo-Jetës;
- sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.18% të tregut të Jo-Jetës.

## Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 15.54% krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 64.87% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-maj 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



# ZHVILLIME TË TJERA

## AMF zhvillon trajnime për vlerësues dëmsh në sigurime



Gjatë zhvillimit të trajnimeve për vlerësues dëmsh në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet Qendrës së Edukimit organizoi në datat 1-3 qershor dhe 8-9 qershor trajnimin për kualifikim profesional për vlerësues dëmsh në sigurime dhe në datat 4-5 qershor dhe 10-12 qershor trajnimin për edukim në vazhdim për vlerësues dëmsh në sigurime.

Z. William Cundiff, ekspert i pavarur në fushën e sigurimeve dhe me eksperiencë më shumë se 20-vjeçare, i njohur nga Autoriteti për shërbimet e tij profesionale në trajnimin e stafit të tij, drejtoi trajnimet, të cilat u zhvilluan në ambientet e AMF-së.

Për trajnimet e formimit profesional për vlerësues dëmsh në sigurime, Qendra angazhoi gjithashtu z. Gedeon Dudushi, jurist me eksperiencë disa vjeçare, i punësuar në një nga shoqëritë e sigurimeve, për të shpjeguar anën juridike të kontratave të sigurimit, problematikën e hasur në gjykatë. Një nga vlerësuesit më të vjetër në treg, z. Stefan Thomagjini, zhvilloi ushtrime praktike duke dhënë eksperiencën e tij për mënyrën e llogaritjes dhe vlerësimit të dëmit në praktikë. Qendra angazhoi edhe punonjësit e Autoritetit për të shpjeguar legjislacionin në fushën e sigurimeve edhe ndryshimet më të fundit të tij.

Në këto trajnime të para të organizuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet Qendrës së Edukimit u diskutua për:

- » Kuadrin ligjor dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë të vlerësuesit të dëmeve në sigurime;
- » Tregun e sigurimeve dhe kushtet e kontratave;
- » Dëmet materiale motorike;
- » Dëmet materiale të pronës;
- » Dëmet materiale të shëndetit;
- » Etikën në sigurime;
- » Mashtrimet në sigurime, etj.

Në këto trajnime morën pjesë ata individë të cilët kishin aplikuar për t'u licencuar për herë të parë në Autoritet, si dhe ata profesionistë që ushtrojnë profesionin si vlerësues dëmsh në sigurime, të cilët kishin aplikuar për t'u rilicencuar.

Me shumë interes për pjesëmarrësit ishte sidomos pjesa e mashtrimeve në sigurime, ku Z. Cundiff ilustroi me raste konkrete mashtrimet që ndodhin në sigurime, duke sjellë pjesë nga eksperiencia e tij shumëvjeçare. Gjithashtu interes i madh u tregua për shpjegimin nga ana juridike të kontratave të sigurimit dhe problematikën e hasur në gjykatë. Rastet konkrete dhe ushtrimet praktike për mënyrën e llogaritjes dhe vlerësimit të dëmit rezultuan shumë efikase.

Këto trajnime iu ofruan pjesëmarrësve dhe profesionistëve të fushës një platformë për të shkëmbyer ide dhe për të diskutuar edhe mbi ndryshimet e kuadrit rregullator.

## Simpoziumi i XIII ndërkombëtar i sigurimeve

### “Menaxhimi i rrezikut të katastrofave dhe zhvillimi i qëndrueshëm”

Shoqata Aktuariale e Serbisë në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Beogradit zhvilluan në datat 5-7 qershor, në Beograd, Simpoziumin e XIII Ndërkombëtar të Sigurimeve “Menaxhimi i rrezikut të katastrofave dhe zhvillimi i qëndrueshëm”.

Fenomeni i ekspozimit ndaj rrezikut të katastrofave natyrore dhe njerëzore, kryesisht gjatë dekadave të fundit, rezulton me shtim të numrit dhe vlerave të dëmeve të ndodhura në mbarë botën. Sipas statistikave të nxjerra nga Banka Botërore, vende si Shqipëria edhe Serbia karakterizohen nga një penetrim i ulët, me rreth 2%, të sigurimit të pasurisë në rast katastrofash. Kjo ishte pikënisja e mbajtjes së këtij simpoziumi. Ndër temat që u diskutuan në simpozium ishin:

- » Ndikimi i përmbytjeve në sektorin e sigurimeve në Republikën e Serbisë;
- » Roli i institucioneve financiare ndërkombëtare në zhvillimin e sigurimit të katastrofave natyrore në Evropën Juglindore;
- » Roli i qeverisë në menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore;
- » Modeli rus mbi menaxhimin e rreziqeve të katastrofave të shkaktuara nga njeriu;
- » Sigurimi i rrezikut të katastrofave në Gjermani;
- » Menaxhimi i rrezikut të katastrofave në Malin e Zi;
- » Menaxhimi i rrezikut të katastrofave në Shqipëri;
- » Sigurimi i rrezikut të katastrofave në Bosnje-Hercegovinë;
- » Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të pronës në industrinë e drurit;
- » Matja dhe vlerësimi i rrezikut të katastrofave sipas konceptit të *Solvency II*;
- » Pasojat katastrofike të incidenteve rrugore gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, etj.

Në simpozium një rëndësi e veçantë ju dha shkakut dhe pasojave të rreziqeve ndaj katastrofave (natyrore dhe njerëzore), tek të cilat konstatohet një rritje e intensitetit, si dhe frekuencës së ndodhjes gjatë dekadave të fundit. Vendet pjesëmarrëse sollën eksperiencën e vendit përfaqësues lidhur mbi ekspozimin dhe trajtimin e rrezikut të katastrofave.

Sipas vlerësimeve të ekspertëve, parashikohet që deri në vitin 2050 numri mesatar i viktimave, për një vit, do të rritet deri në rreth 100,000 dhe vlera mesatare vjetore e humbjeve për të njëjtën periudhë do të arrijë në rreth 300 miliardë dollarë në mbarë botën.

Vendet në zhvillim si Shqipëria apo Serbia, janë shumë të ndjeshme ndaj pasojave të humbjeve katastrofike, për këtë arsye është shumë e rëndësishme krijimi i modeleve të matjes dhe vlerësimit të ekspozimit dhe menaxhimit ndaj rrezikut të katastrofave natyrore apo njerëzore.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë ekspozimin e lartë që ka Shqipëria ndaj përmbytjeve, duhet të shihet me një rëndësi të veçantë sigurimi i kulturave bujqësore duke bërë propozime për zhvillimin e saj.

Në këtë simpozium merrnin pjesë aktuarë, akademikë, ekspertë të fushës së sigurimeve nga shtete të rajonit dhe më gjerë, si: Rusia, Gjermania, Sllovenia, Bosnje-Hercegovina, Republika Serbe e Bosnje-Hercegovinës, Mali i Zi, si dhe përfaqësues të Bankës Botërore.

## Takimi i grupit të punës mbi pensionet private dhe i përfaqësuesve të vendeve anëtare të IOPS-it

Në datat 22-24 qershor në Paris, Francë, u zhvillua takimi i grupit të punës mbi pensionet private dhe takimi i përfaqësuesve të vendeve anëtare të IOPS-it (*International Organization on Pension Supervision*).

Temat kryesore të këtij takimi ishin ato që lidheshin me edukimin financiar dhe planifikimin e daljes në pension. Gjatë ditëve të konferencës u diskutua edhe mbi materialet që trajtonin çështje në lidhje me nevojën e edukimit të anëtarëve të fondeve të pensioneve, të cilët presin ekzekutimin e të drejtës së përfitimit të pensionit. Pjesëmarrësit diskutuan mbi mundësinë e shfrytëzimit të parimeve dhe praktikave më të mira të OECD-së për edukimin financiar në fushën e pensioneve, me qëllim orientimin e hartuesve të politikave për të ndërmarrë iniciativa ndërgjegjëse lidhur me planifikimin e daljes në pension.

Në panele të veçanta në takim, u diskutua mbi normat e ulëta të interesit mbi vlerën e aseteve të fondeve të pensionit. Pjesëmarrësit u shprehën se efektet e këtyre normave të ulëta të interesit, në se një tendencë e tillë do të vazhdojë për një kohë të gjatë, mund të çojnë në dekurajim të konsumatorëve, si edhe në efekte negative për fondet e pensioneve dhe kompanitë e sigurimit të Jetës.

Diskutim i hapur në takim u zhvillua për aspektet mbikëqyrëse dhe rregullative të politikave të investimit të aseteve të fondit të pensionit. Anëtarët diskutuan praktikatat aktuale të politikave të investimit duke dhënë eksperiencën e tyre, si dhe mundësinë për rishikimin në të ardhmen të këtyre politikave në përputhje me ndryshimet e tregut të pensioneve. Pjesëmarrësit nga vendet anëtare të IOPS-it diskutuan dhe ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me mbikëqyrjen efektive të fondeve të pensionit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.



# LAJMET NGA RAJONI

## BOSNJE-HERCEGOVINË

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të publikuara nga dy autoritetet rregullatore në treg, Agjencia e Sigurimeve të Republikës Serbe të Bosnjes (AZORS) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Federatës së Bosnje-Hercegovinës (NADOS), në tre muajt e parë të vitit 2015, tregu i sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës arriti një total prej afërsisht 70 milionë euro, 0.4% më shumë sesa vitin e kaluar. Kjo erdhi si rezultat i një rritjeje prej më shumë se 5.5% të kompanive të sigurimit të vendosura në Republikën Serbe të Bosnjes. Volumi i primeve të shkruara bruto të siguruesve të Federatës së Bosnje-Hercegovinës u ul me 1.5% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur një total prej 50.1 milionë euro.

Në total, segmenti i sigurimit të Jetës llogaritet në rreth 14.6 milionë euro (afërsisht 21%), ndërkohë që pjesa e mbetur prej 55.3 milionë euro i përket sigurimit të Jo-Jetës. Sigurimi i Jo-Jetës pati një dinamikë negative në ulje prej 1.1% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa sigurimi i Jetës pati rritje prej 6.5%. Klasat e sigurimit motorik zunë rreth 53% të portofolit të tregut.

## BULLGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave tremujore të publikuara në faqen zyrtare të rregullatorit financiar, totali i primeve të shkruara bruto të siguruesve bullgarë në tre muajt e parë të vitit 2015 ishte 506 milionë BGN (Leva Bullgare) ose 258.7 milionë euro, me një rritje prej 13.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 32% duke arritur në 259 milionë BGN, 132.5 milionë euro.

Sigurimi i Jo-Jetës në Bullgari u llogarit për 78% të totalit të tregut kundrejt 80.8% që ishte në tremujorin e parë të vitit 2014. Në vlera absolute, primet e shkruara bruto të Jo-Jetës u rritën me një përqindje vjetore prej 9.5% duke arritur në 395 milionë BGN. Volumin kryesor të primeve të shkruara bruto, për klasat e Jo-Jetës e kishin dy kategoritë e sigurimit për mjetet motorike (MTPL dhe Kasko) dhe linja e sigurimit të pronës (sigurimet ndaj zjarrit, rreziqet e lidhura me të dhe dëmet ndaj pronës, të mbledhura së bashku). Këto tre linja të biznesit gjeneruan rreth 67.2% të totalit të primeve të shkruara bruto. Përqindjet e rritjes të raportuara për këto

segmente ishin 8% për MTPL, 12.6% për sigurimin Kasko dhe 13.2% për kontratat e pronës. Në aspektin e dëmeve të paguara, sigurimet e pronës dhe mjeteve motorike zunë më shumë se 80% të totalit të tregut, rreth 208 milionë BGN ose rreth 106.35 milionë euro.

Sigurimi i Jetës, në tremujorin e parë të vitit 2015, pati një rritje prej 29% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dinamika pozitive e këtij segmenti u udhëhoq nga një përqindje rritjeje prej 355% e raportuar nga produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me skema investimesh (unit-linked products) dhe me 12% rritje në kontratat tradicionale për sigurimin e Jetës.

## ÇEKI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Rezultatet e kompanive anëtare të Shoqatës së Siguruesve të Çekisë (*Czech Insurance Association, CAP*) për tremujorin e parë të vitit 2015 tregojnë një rritje prej 0.5% të primeve vjetore në total. Ngërçi i tregut vjen kryesisht nga një rënie e vazhdueshme në sigurimin e Jetës. Sigurimi i Jo-Jetës ka një përmirësim të lehtë, nga 2.3% rritje në fund të vitit 2014, në 2.6% në fund të tremujorit të parë 2015.

Sipas informacionit të publikuar nga Shoqata e Siguruesve të Çekisë, primet e shkruara të sigurimit të Jetës, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u ulën me 335 milionë CZK, (Korona Çeke) duke arritur në 11.4 miliardë CZK (rreth 419 milionë euro). Në mënyrë të veçantë, kontratat në sigurimet e Jetës me pagesë totale që në fillim (*single premium contract*) raportuan një ulje të ndjeshme, me rënie në primet vjetore prej 18.5%, ndërkohë që kontratat aktuale të pagesave të primeve pësuan një rënie me 1.7%. Në total, tregu i sigurimit të Jetës pësoi një rënie vjetore në numrin e kontratave të sigurimit të Jetës.

Sigurimi i Jo-Jetës vazhdoi të rritet me afro 484 milionë CZK (17.78 milionë euro) krahasuar me fundin e vitit 2014. Ndryshe nga rritja prej 4.6% në vitin 2014, primet e shkruara në sigurimin MTPL pësuan një rënie të vogël me 0.3% në tremujorin e parë të vitit 2015.

## LITUANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacionit të publikuar nga Banka e Lituanisë, në tremujorin e parë të vitit 2015, në tregun lituanëz të sigurimeve, volumi i primeve të shkruara bruto u rrit me 6.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 150.7 milionë euro. Kjo është performanca më e lartë e primeve të shkruara për tremujorin e parë, në historikun e tregut vendas.

## MAQEDONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu vendas i sigurimeve është ende në zhvillim, me një depërtim të sigurimeve prej 1.45% në vitin 2014 dhe një dendësi sigurimesh prej 60 euro/person, në krahasim me 57 euro që ishte kjo shifër në vitin 2013. Nga 11 kompani sigurimi të Jo-Jetës, 6 janë aktive në linjën bujqësore të biznesit. Deri në vitin 2013 vetëm 4 kompani ishin aktive. Sigurimet bujqësore përfaqësojnë 1.12% të totalit të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës. Gjatë viteve të fundit, sigurimi bujqësor pati një rritje pozitive për shkak të masave të zbatuara nga Qeveria e Maqedonisë, e cila vendosi të subvenciononte 60% të primeve të sigurimeve bujqësore. Në të njëjtën kohë, autoritetet publike investuan në fushata ndërgjegjësuuese dhe edukative për këtë lloj të veçantë sigurimi.

## SERBI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të Bankës Qendrore të Serbisë, në tremujorin e parë të vitit 2015, volumi i primeve të mbledhura nga 21 kompani sigurimesh që ushtrojnë veprimtarinë në Serbi u rrit me 27.15%. Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës gjeneruan 78.39% të primeve në total, ndërkohë që përqindja e segmentit të Jetës arriti në 21.61%.

Me përjashtim të sigurimit Kasko që pësoi një rënie prej -1.10%, të gjitha nënkategoritë kryesore raportuan dinamika pozitive: MTPL pati rritje prej +45.81%, sigurimi i pronës u rrit me +27.05%, dhe sigurimet në udhëtim u rritën me +14.92%.

Volumi i dëmeve të paguara nga sigruerit vendas ishte 6.33 miliardë RSD (53 milionë euro), duke zbritur me 1.33% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të Shoqatës së Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve, në fund të muajit mars të vitit 2015 arriti një total prej 547.10 milionë euro, ose 1.67% më pak krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014. Vlera e dëmeve të paguara u rrit në vlerë absolute me 3.63 milionë euro duke arritur në 332.61 milionë euro, nga të cilat 100.30 milionë euro ishin pagesa dëmsh në sektorin e Jetës dhe 232.31 milionë euro dëme të paguara në sigurimet e Jo-Jetës.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën një total prej 410.67 milionë euro duke shënuar rënie me 1.92% në krahasim me vitin e kaluar. Sigurimet e Jetës arritën një volum të primeve të shkruara prej 136.43 milionë euro ose 0.91% më pak sesa vitin e kaluar.

## TURQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas publikimeve në faqen zyrtare online të Shoqatës Turke të Sigurimeve, në fund të muajit mars të vitit 2015, sektori turk i sigurimeve arriti një total prej 7.9 miliardë TRY (2.8 miliardë euro), duke u rritur 13.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto u dominuan nga sigurimi i pronës (sigurimet ndaj zjarrit, rreziqet e lidhura me të dhe dëmet e tjera të pronës, të mbledhura së bashku) me 28.8% të totalit, MTPL me 17.5% e totalit të primeve të shkruara bruto, sigurimet Kasko me 16.2%, sigurimi i shëndetit me 14.8% dhe sigurimi i Jetës me 11.9%. Pjesa e mbetur prej 10.7% lidhej me kategoritë e tjera të sigurimit të Jo-Jetës.

Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara nga siguroesit vendas u rrit me 15.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 3.7 miliardë TRY (Lira Turke) ose 1.3 miliardë euro. Nga ky total, rreth 27% lidheshin me kontratat TPL për mjetet motorike, 23% për sigurimet vullnetare Kasko, 16% për sigurimin e shëndetit, 15% për linjat e pronës dhe 14% për pagesat e dëmeve nga kontratat e sigurimit të Jetës.